

# Privatizimi në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit serb

2022





---

# 1.

Asociacioni i Komunave Serbe në Limbon e Marrëveshjeve të Papërbushura

---

# 2.

Loja e numrave: Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur 20 vjet më vonë

---

# 3.

Një tjetër mollë sherri: KOS në Dialogun për Normalizimin e marrëdhënieve

---

# 4.

Furnizimi me energji elektrike në veri të Kosovës

---

# 5.

Privatizimi në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit Serb

---

# 6.

Liria e lëvizjes: Episoda stiker

**Titulli i hulumtimit:** Privatizimi në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit serb

**Botues:** Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

**Për botuesin:** Instituti për zhvillim ekonomik territorial - InTER

**Autorë:** Dragiša Mijačić dhe dr Vesela Vlašković

**Lektore:** Tatjana Potežica

**Përkthimi:** Be Translated

Gjuha origjinale në të cilën është hartuar analiza është gjuha serbe.

**Dizajn:** tedel

**Shtypshkronja (Tirazhi):** 80

Ky publikim u përgatit në kuadër të projektit OPEN që implementohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me Institutin për zhvillim ekonomik territorial - InTER. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim u përkasin ekskluzivisht autorëve të hulumtimit dhe nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it

**Viti i publikimit:** 2022

# PËRMBAJTJA

---

Rreth Nismës Open 07

---

## 01.

---

HYRJE 08

---

## 02.

---

PRIVATIZIMI NË KOSOVË NË PERIUdhËN DERI NË VITIN 2008 09

---

## 03.

---

PRIVATIZIMI NË KOSOVË NË PERIUdhËN PAS VITIT 2008 14

---

## 04.

---

PRIVATIZIMI NË MJEDISËT SERBE NË KOSOVË 16

---

## 05.

---

REPUBLIKA E SERBIË DHE PRIVATIZIMI NË KOSOVË 19

---

## 06.

---

PËRFUNDIM 20

---



## Rreth Nismës Open

“Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - OPEN” është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Kjo nismë ka për synim të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

Organizatave e shoqërisë civile dhe mediat nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, në mënyrë specifike merren me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile dhe politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në hapjen e komunitetit serb në Kosovë. Përmes këtyre analizave vlerësohet se sa janë të hapura institucionet, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe vlerësohet shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë që të kuptohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj vendimmarrësve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

# 1. Hyrje

Përveç sfidave tradicionale që sjell çdo privatizim i ndërmarrjeve dhe pronave shtetërore dhe shoqërore në ekonominë në transicion, ky proces në Kosovë ka pasur edhe vështirësi shtesë që u pasqyruan në kornizën ligjore jo të definuar mjaft qartë, probleme që kishin të bënin me përcaktimin e pronësisë së pronave të ndërmarrjeve që janë objekt i privatizimit, por edhe shumë situata të tjera që janë karakteristike ekskluzivisht për Kosovën. Pas miratimit të Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, u krijua Misioni i UNMIK-ut në Kosovë, i cili mori përsipër ndërtimin e sistemit dhe të institucioneve juridike, por edhe menaxhimin e pronës publike, shtetërore dhe shoqërore të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë. Gjatë atyre viteve, por edhe pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, privatizimi ishte dhe mbetet një nga politikat publike më të diskutueshme

në këtë këto treva, përmes të cilit kryqëzoheshin mosmarrëveshjet juridike dhe interesat e ndryshme, gjë që ka ndikuar edhe në thellimin e mosbesimit në marrëdhëniet ndërmjet komunitetit serb dhe institucioneve të Kosovës.

Në këtë dokument jepet një pasqyrë historike e instrumenteve ligjore dhe institucionale për privatizimin në Kosovë në kohën, para dhe pas shpalljes së pavarësisë, si dhe pasojat që ky proces pati në mjediset serbe. Po ashtu, duhet theksuar se kjo analizë paraqet një nga publikimet e rralla në temën e privatizimit në mjediset serbe në Kosovë. Mungesa e publikimeve të ngjashme, mes tjerash, lidhet drejt-përdrejt me problemin e pasjes së informatave me rëndësi publike në dispozicion që janë të domosdoshme për përgatitjen e një studimi gjithëpërfshirës që do ta trajtonte këtë temë në mënyrë adekuate.



## 2. Privatizimi në Kosovë në periudhën deri në vitin 2008

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejme i referohemi si RKSKB1244/99) parasheh mandat të Kombeve të Bashkuara që është në përputhje me sistemin ligjor të OKB-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Kjo rezolutë krijoi bazën ligjore për krijimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në tekstin e mëtejme: UNMIK)<sup>2</sup> me detyrën e krijimit të një administrate (të përkohshme) që do të menaxhonte të gjitha marrëdhëniet shoqërore-politike dhe ndërtimin e institucioneve.

Misioni i UNMIK-ut ndërtoi kornizën ligjore përmes rregulloreve të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme: PSSP). Rregullorja e parë u miratua më 25 korrik 1999, dhe në nenin 6 ajo përcaktonte se UNMIK-u administron (menaxhon) të gjithë pasurinë e tundshme ose të patundshme të Republikës Federative të Jugosllavisë, të Republikës së Serbisë apo të cilitdo organ të saj, që gjendet në territorin e Kosovës.<sup>3</sup> Kësisoj, UNMIK-u inicioi krijimin e kornizës institucionale për menaxhimin e pronës shtetërore dhe shoqërore, që më vonë u normua më hollësisht në Kornizën Kushtetuese

për krijimin e institucioneve të përkohshme të Kosovës.<sup>4</sup>

Në Kornizën Kushtetuese, menaxhimi i pronës shtetërore dhe shoqërore është kompetencë ekskluzive e PSSP-së (neni 8.1(q) i Kornizës Kushtetuese), por që PSSP-ja për këto detyra do të bashkëpunojë me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal, i cili është pjesë e Shtyllës së Katërt të Administratës së UNMIK-ut nën patronazhin e Bashkimit Evropian<sup>5</sup> dhe me institucionet e përkohshme të Kosovës (neni 8.1(r) i Kornizës Kushtetuese). UNMIK-u, me Rregulloren nr. 2002/12 të vitit 2002, themeloi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM)<sup>6</sup> me mandat që të ndihmojë në menaxhimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore. Bazuar në nenin 6.2 të kësaj Rregulloreje, AKM-së i është dhënë mandati që të kryejë transformimin e ndërmarrjeve shoqërore në një ose më shumë pjesë, të shesë të gjitha ose një pjesë të filialeve të ndërmarrjes, të fillojë procesin e likuidimit

4 UNMIK/REG/2001/9 e 15 majit 2001, gjendet në [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2001regs/RE2001\\_09.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2001regs/RE2001_09.pdf)

5 Misioni i UNMIK-ut është i ndarë në katër pjesë ose "shtylla" (eng. *pillar*): Shtylla e parë: Policia dhe gjyqësori (nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara); Shtylla e dytë: Administrata civile (nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara); Shtylla e tretë: Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve (nën udhëheqjen e OSBE-së); dhe Shtylla e Katërt: Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik (nën udhëheqjen e Bashkimit Evropian);

6 UNMIK/REG/2002/12 e 13 qershorit 2002, gjendet në [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2002regs/RE2002\\_12.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2002regs/RE2002_12.pdf)

1 <https://unmik.unmissions.org/united-nations-resolution-1244>

2 UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

3 UNMIK/REG/1999/1 e 25 korrikut 1999, gjendet në [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E1999regs/RE1999\\_01.htm](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E1999regs/RE1999_01.htm)

të ndërmarrjes ose të vendose për posedimin e parave dhe pasurisë tjetër të ndërmarrjes. Me këtë Rregullore, AKM-ja themelohet si organ të pavarur në përputhje me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese. Një pjesë e konsiderueshme e kornizës ligjore për menaxhimin e pronës shtetërore dhe shoqërore përfaqësohet nga Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13<sup>7</sup>, e cila ofron bazën ligjore për formimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet relevante me funksionimin e AKM. Me qëllim të përshejtit të mëtejme të procesit të privatizimit, baza ligjore për punën e AKM-së u avancua me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18 të 22 prillit 2005,<sup>8</sup> me të cilën fuqizohet edhe më tej pavarësia dhe rëndësia e kësaj agjencie në kuadër të institucioneve të përkohshme të Kosovës.

Ekziston një shqetësim i justifikuar se me themelimin e AKM-së, UNMIK-u doli nga mandati që i ishte caktuar me Rezolutën 1244/1999 të KSKB-ve, i cili u përkufizua më tej me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1. Përkatesisht, e drejta për të menaxhuar me pronën publike, shtetërore dhe shoqërore iu dha UNMIK-ut pa të drejtë ndryshimi të strukturës së pronësisë. Prandaj, procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë shkaktoi polemika që nga fillimi.<sup>9</sup> Përveç kësaj, nuk ishte e lehtë për UNMIK-un që të përcaktonte marrëdhëniet e pronësisë në ndërmarrjet shoqërore, gjë që çoi në një ndalje të përkohshme të procesit menjëherë pas përfundimit të valës së parë të privatizimit në korrik të vitit 2003.<sup>10</sup>

7 UNMIK/REG/2002/13 e 13 qershorit 2002, gjenet në <http://www.kta-kosovo.org/ktareg/UNMIK%20Regulation%20No.%202002-13%20Special%20Chamber%20of%20the%20Supreme%20.pdf>

8 UNMIK/REG/2005/18 e 22 prillit 2002, gjendet në <http://www.kta-kosovo.org/ktareg/UNMIK%20Regulation%20No.%202002-12%20Establishing%20the%20KTA.pdf>

9 Mulaj, Isa. "Privatizimi i vonuar në Kosovë: shkaqet, pasojat dhe implikimet në procesin e vazhdueshëm", në *Zhvillimi i varur nga rruga në Ballkanin Perëndimor*. Ndikimi i Privatizimit, Siniša Kušić, ed., Frankfurt: Peter Lang, 2005, 123-163.

10 Privatizimi dhe Post-Privatizimi në Kosovë: Gota gjysmë bosh apo gjysmë e mbushur? Raporti i Riinvestit, shtator 2008, gjendet në [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/english\\_en1476702396.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/english_en1476702396.pdf)

## Modelet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë

Pas ngeçjes fillestare, privatizimi vazhdoi në vitin 2004, kur qe miratuar një model që nënkuptonte privatizim pa zgjidhje paraprake të të drejtave të pronësisë. Ky model ende quhet "metoda *spin-off*" dhe përfshinte modele të ndryshme të transformimit të ndërmarrjeve shoqërore para procesit të privatizimit, përkatesisht:

1. Metoda e *spin-off-it* të rregullt;
2. Metoda e *spin-off-it* special,<sup>11</sup>
3. Procedura e likuidimit.

Me modelin *spin-off* bëhet ndarja formale e asetëve (toka, godinat, sallat, makineritë dhe pajisjet e tjera) dhe e detyrimeve të ndërmarrjes së vjetër. Në këtë mënyrë ndahen të drejtat dhe obligimet mbi atë ndërmarrje, me qëllim që pronarët e rinj të lirohen nga detyrimet e ndërmarrjes së vjetër.<sup>12</sup>

Nga modelet e cekura, në shumicën e rasteve është përdorur *spin-off-i* të rregullt, që nënkupton krijimin e një ose më shumë filialeve të një ndërmarrje shoqërore në formën e një shoqërie aksionare ose një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, pastaj transferimin të asetëve ose një pjesë të asetëve nga ndërmarrja e vjetër në atë të re (*Ndërmarrja e Re*), të gjitha me qëllim shitjen e mëtejshme përmes tenderit të të gjitha ose një pjesë të aksioneve të ndërmarrjes së re, me emër të ri. Para shitjes, aksionet e ndërmarrjes/kompanisë së sapokrijuar mbeten në pronësi të përkohshme të AKM-së (deri në shitje) në formën e një kompanie aksionare e cila po ashtu menaxhohet nga AKM-ja (më saktë nga Bordi Menaxhues i AKM-së).

*Spin-off-i* special ka të bëjë me privatizimin i ndërmarrjeve të mëdha dhe me rëndësi strategjike me numër të madh punonjësish dhe

11 Në Kosovë kishte 23 kompani me *spin-off* të veçantë. Burimi: po aty, f.5.

12 Davidoviq, Sandra, Privatizacija društvenih preduzeća na Kosovu i Metohiji pod okriljem administracije UNMIK: pregled, ocene, zaključci, Beogradski forum za svet ravnopravnih, Beograd 2018.

ku shitja kufizohet nën kushte të veçanta që investitori duhet t'i plotësojë për sa i përket punonjësve, ruajtjes së veprimtarisë së biznesit dhe respektimit e mbrojtjes së mjedisit dhe r standardeve teknologjike. AKM-ja, çdo ndërmarrje me të paktën 150 punëtorë dhe një qarkullim potencial prej 10 milionë eurosh e konsideron ndërmarrje me rëndësi strategjike për Kosovën.<sup>13</sup> Në procesin e privatizimit u identifikuan gjithsej 23 ndërmarrje, të cilave iu dha statusi i *spin-off-it* special.

Procedura e privatizimit sipas modelit me *spin-off* është përcaktuar me rregulloren e AKM-së me titull "Rregullat e tenderit për procedurën e privatizimit me *spin-off* të rregullt për tenderin dhe shitjen e ndërmarrjeve shoqërore."<sup>14</sup> Ky dokument përshkruan shitjen e aksioneve në një ankand publik, gjatë të cilit ofertat do të renditen në bazë të çmimit më të lartë të ofruar. Siç u cek më lart, në procesin e shitjes me *spin-off* special, merren parasysh kriteret shtesë, kështu që privatizimi organizohet në dy runde tenderimi në të cilat merren parasysh tre kriteret: çmimi i ofruar, garancitë e punësimit, garancitë e investimit.

Mjetet e realizuara nga shitja e ndërmarrjes së re, në formë të të ardhurave në para ose aksione, vendosen në një fond mirëbesimi, që menaxhohet nga AKM-ja. Parashikohet që fondet nga shitja të shpërndahen si më poshtë:

**Punonjësit e ndërmarrjeve shoqërore,**

**20%**

**Shpenzimet administrative,**

**5%**

**Kreditorët dhe pronarët**

**75%.<sup>15</sup>**

13 Privatizimi në Kosovë: Shqyrtimi Juridik i Çështjeve të AKM-së nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Raporti: Maj 2008, f. 11.

14 Rregullorja gjendet në ueb faqen e AKM-së, linku: <http://www.kta-kosovo.org/ktareg/srulesoftender.pdf>

15 Davidoviç, Sandra, Privatizacija društvenih preduzeća na Kosovu i Metohiji pod okriljem administracije UNMIK: pregled, ocene, zaključci, Beogradski forum za svet ravnopravnih, Beograd 2018.

E drejta për ndarje të pjesës nuk është drejtpërdrejt e realizueshme. Realizimi i këtyre të drejtave kërkon plotësimin paraprak të kushteve të përcaktuara dhe të vlerësuara nga AKM-ja. Në tender mund të marrin pjesë të gjithë personat juridikë dhe fizikë, përveç ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, institucioneve qeveritare, personave juridikë në falimentim dhe personave të shpallur penalisht përgjegjës për krime lufte dhe krime të tjera. Megjithatë, asnjë dispozitë nuk e ka përcaktuar metodologjinë për përcaktimin e çmimit fillestar për një ndërmarrje që del në tender. Në praktikë, deri te çmimi fillestar shpesh është arritur me një lloj marrëveshjeje paraprake ndërmjet pronarit të mundshëm dhe AKM-së, e kështu është vendosur një kriter që i referohet se sa një blerës është i gatshëm të paguajë dhe se ai çmim duhet të jetë minimalisht i pranueshëm për AKM-në.<sup>16</sup>

Likuidimi vullnetar ishte forma e tretë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Krahasuar me metodat e *spin-off-it*, një numër shumë më i vogël ndërmarrjesh kaluan në procesin e likuidimit (rreth 10% e totalit). Kjo metodë përfshin shuarjen e një ndërmarrje që nuk është në gjendje të vazhdojë me afarizëm të qëndrueshëm. Nëse vlerëson se kjo është në interes të kreditorëve dhe/ose pronarëve të asaj ndërmarrje,<sup>17</sup>AKM-ja mund të iniciojë likuidimin vullnetar të ndërmarrjes shoqërore ose të një pjese të saj. Kjo procedurë zhvillohet jashtë gjykatës, në përputhje me procedurat për likuidim që gjenden në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6 për Shoqëritë Tregtare,<sup>18</sup> me çrast të ardhurat nga likuidimi i jepen AKM-së për ruajtje dhe menaxhim në të njëjtën mënyrë si në rastin e modelit *spin-off*.<sup>19</sup>

Baza e modelit të përcaktuar të privatizimit është shitja e asetëve, pra e pjesës "së shëndetshme" të ndërmarrjes. Me këtë i është përgjigjur kërkesës

16 Privatizimi në Kosovë: Shqyrtimi Juridik i Çështjeve të AKM-së nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Raporti: Maj 2008, f. 17.

17 Këtu duhet theksuar edhe një herë problemi i përcaktimit të pronësisë së ndërmarrjeve shoqërore, apo kreditorëve të tyre.

18 UNMIK/REG/2001/6 e 8 shkurtit 2001, gjendet në [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2001regs/RE2001\\_06.htm](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2001regs/RE2001_06.htm)

19 Privatizimi në Kosovë: Shqyrtimi Juridik i Çështjeve të AKM-së nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Raporti: Maj 2008, f. 19.

që ndërmarrja e privatizuar të fillojë sa më shpejt veprimtarinë ekonomike, e liruar nga çështjet e pazgjidhura të pretendimeve. Kjo veçori ka sjellë një sërë problemesh, në radhë të parë në lidhje me të drejtat e pronarëve dhe të kreditorëve. Kreditorët, në kundërshtim me praktikën juridike krahasuese, injorohen në procesin e shitjes së filialit, sepse blerësi i ri nuk merr përsipër asnjë detyrim. Me dispozitën për rezervimin e një pjese të të ardhurave nga shitjet mundësohet kompensimi financiar i mëvonshëm, por bëhet fjalë vetëm për mundësi. Domethënë, kjo varet nga të hyrat gjithmbarshme nga privatizimi, shlyerja e pretenduesve të tjerë dhe pastaj vërtetimi i pretendimit të dhënë si jo diskriminues.<sup>20</sup>

UNMIK-u u përpoq që të kënaqte interesat e pronarëve, si në rastin e kreditorëve, duke rezervuar një pjesë të të hyrave nga privatizimi. Megjithatë, vendosja e parimit të kompensimit monetar në rastin e pronarit nuk do të thotë zgjidhje e problemit të pronësisë. Fjala është një përgjigje teknike të përkohshme ndaj një problemi thelbësor ligjor që vjen me transformimin e pronësisë. Është e qartë se kjo është pasojë e distancës së vendosur nga UNMIK-u lidhur me vlerësimin përfundimtar nëse ky model i privatizimit hyn në të vërtetë në sferën e shkëlqes së të drejtave pronësore. Megjithatë, nuk është e qartë se kujt, UNMIK-u ose institucionet e përkohshme të Kosovës, ia kanë lënë zgjidhjen përfundimtare problemit të së drejtës pronësore, e cila sigurisht mbetet një kërkesë e përhershme sa i përket kontesteve pronësore në Kosovë. E pazgjidhur ose pjesërisht e zgjidhur, kjo mund të bëhet baza e konflikteve të ardhshme, gjë që vë në pikëpyetje idenë e rindërtimit pas konfliktit, që është baza e misionit të UNMIK-ut. Duke marrë parasysh pjesën e palës serbe në strukturën e pronësisë, ky model u shndërrua në instrument të diskriminimit të njëres palë në kontestin e Kosovës. Përveç kësaj, është me rëndësi të ceket fakti se në kohën e privatizimit në Kosovë, Qeveria e Serbisë ende i shlyente borxhet ndërmarrjeve kosovare dhe kështu mbante barrën e përbushjes së kërkesave të kreditorëve ndërkombëtarë. Prandaj, autoritetet

<sup>20</sup> Davidovič, Sandra, Privatizacija društvenih preduzeća na Kosovu i Metohiji pod okriljem administracije UNMIK: pregled, ocene, zaključci, Beogradski forum za svet ravnopravnih, Beograd 2018.

e Qeverisë së Serbisë kërkuar nga UNMIK-u që një pjesë e të hyrave nga privatizimi në Kosovë të përdoren për të shlyer pjesën e borxhit publik të Kosovës, por administrata e UNMIK-ut u deklarua jo kompetente lidhur me këtë kërkesë.<sup>21</sup>

U parashtrua pyetja nëse problemi i arkëtimit të pretendimeve të arkëtueshme lidhej me modelin e zgjedhur të privatizimit. Konkretisht, pse u zgjedhur modeli *spin-off*, në vend të, le të themi, falimentimit, aq më tepër pasi që shumica e ndërmarrjeve pothuajse i plotësonin të gjitha kërkesat për fillimin e procedurave të falimentimit për shkak të borxhit. Në këtë mënyrë kreditorët do të shlyeshin nga pasuria e falimentimit dhe vetëm atëherë do të shqyrtohej mundësia e shitjes së pjesës tjetër të ndërmarrjes dhe jo anasjelltas, siç ndodhte në shumicën e modeleve të realizuara me *spin-off*.<sup>22</sup> Pa një bazë solide ligjore dhe me mungesë legjitimiteti, kjo kornizë është vendosur si një model jo instruktiv privatizimi, që i përgjigjet kontekstit territorial dhe shoqëroro-politik të Kosovës, edhe pse të gjitha mangësitë dhe gjërat e pa logjikshme gjatë procesin e zbatimit do ta tregojnë të kundërtën.

Sipas modelit të propozuar të privatizimit, mes viteve 2004 dhe 2008, mbi 313 ndërmarrje shoqërore janë shitur në formën e 551 ndërmarrjeve të reja, me vetëm 347 blerës nënshkruan kontratat e shitjes. Kësisoj, u realizuan të hyra prej 383 milionë euro, që ishte 11.5% e PBB-së së Kosovës në 2007. Në atë moment ishin rreth 100 ndërmarrje shoqërore që nuk ishin privatizuar, duke përfshirë kompanitë e mëdha si Trepça dhe Qendra e Skijimit Brezovica.<sup>23</sup>

Tabela 1 jep shembujt e transformimit të ndërmarrjeve shoqërore në subjekte të reja afariste që më pas u privatizuan sipas modelit me *spin-off* të rregullt në periudhën deri në vitin 2008.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Petrović, P. "Obim i kontroverze aktuelne dhe najavljene privatizacije na Kosmetu", zbornik radova "Pitanje Kosmeta", Institut za međunarodnu saradnju i privredu, Beograd 2006.

<sup>23</sup> Privatizimi dhe Post-Privatizimi në Kosovë: Gota gjysmë bosh apo gjysmë e mbushur? Raporti i Riinvestit, shtator 2008, gjendet në [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/english\\_en1476702396.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/english_en1476702396.pdf)

**Tabela 1.** Shembuj të transformimit të ndërmarrjeve “të vjetra” në “të reja” të privatizuara deri në vitin 2008.

Nr.	Ndërmarrja “e vjetër”.	Ndërmarrja “e re”.	Spin-off i rregullt ose special	Çmimi i shitjes (EUR)
1.	“Energoinvest” Prishtinë	“Siguresat Energoinvest”	spin-off i rregullt	525,130,00
2.	“Energoinvest” sh.p.k.	Kompania Meridian	spin-off i rregullt	750,000,00
3.	“Zitopromet” Mlinpek, Mitrovicë	Furra IMB	spin-off i rregullt	404,416,66
4.	Mulliri IMB	Auto servis Gashi	spin-off i rregullt	406,000,00
5.	“Farmakos” Prizren	Farmacia “Farmakos”.	spin-off i rregullt	2,310,000,00
6.	Shtëpia austriake “Farmakos”.	Viktoria InvestINT	spin-off i rregullt	310,000,00
7.	“Kosovotrans”, Mitrovicë (Transporti i Kosovës)	Stacioni i autobusëve “Kosovotrans” sh.p.k Skenderaj	spin-off i rregullt	451,750,00
8.	Kompania e makinave RO “Kompresor”.	Kompresori shpk	spin-off i rregullt	715,000,00
9.	“Goša” Fabrika për prodhimin e pajisjeve minerare dhe strukturave metalike “Metalac”	“Steel rollers” shpk	spin-off i rregullt	555,555,00
10.	Hotel “Korzo” Pejë	Hotel “Korzo” shpk Pejë	spin-off i rregullt	915,000,00
11.	PKB “Peçka pivara” doo Pejë	“Birraria e Pejës” Pejë	spin-off i rregullt	11,130,000,00
12.	Shoqëria tregtare me shumicë dhe pakicë “Korenik”, Lindje	Shtëpia e Mallrave “Korenik”, sh.p.k. Istog	spin-off i rregullt	715,000,00
13.	Ndërmarrja tregtare me shumicë dhe pakicë “Korenik”, Istog	Hotel Korenik shpk Gjurakovc	spin-off i rregullt	284,121,00
14.	PD “Staklopan”, Beograd, reparti në Prishtinë	Fabrika Kri Kos shpk Prishtinë	spin-off i rregullt	485,000,00
15.	Kompania Holding fabrika e pambukut “Jumko” a.d Vranje, reparti në Prishtinë dhe F. Kosovë	Fabrika “Jumko” sh.p.k Prishtinë	spin-off i rregullt	1,700,000,00
16.	Kompania Holding fabrika e pambukut “Jumko” a.d Vranje, reparti në Prishtinë dhe F. Kosovë	Jumko Land shpk Prishtinë	spin-off i rregullt	277,000,00
17.	DD “Kosmetput”, Mitrovicë	“Trasing industriale” sh.p.k Prishtinë	spin-off i rregullt	2,250,000,00
18.	PKB “Kosovino” Krushë e Vogël	Veraria “Vera e Kosovës” sh.p.k	spin-off i rregullt	2,700,749,00
19.	DTP „Voçar” Prishtinë	“Supermarketet Urata nr. 1” shpk, Prishtinë	spin-off i rregullt	1,400,111,00
20.	DTP „Voçar” Prishtinë	“Supermarketet Urata nr. 3” shpk, Prishtinë	spin-off i rregullt	1,325,000,00
21.	DTP „Voçar” Prishtinë	“Supermarketet Urata nr. 4” shpk, Prishtinë	spin-off i rregullt	160,150,00
22.	DTP „Voçar” Prishtinë	“Supermarketet Urata nr. 20” shpk, Prishtinë	spin-off i rregullt	250,250,00
23.	DTP “Vocar” Prishtinë	“Supermarketet Urata nr. 47” shpk, Prishtinë	spin-off i rregullt	100,500,00

## 3. Privatizimi në Kosovë në periudhën pas vitit 2008

Me aktin e njëanshëm i shpalljes së pavarësisë u krijua një rrethanë e re kushtetuese-juridike në Kosovë që përcaktoi të gjitha aspektet e shoqërisë, përfshirë edhe marrëdhëniet me pronësinë ndaj pronës publike, shtetërore dhe shoqërore. Duhet theksuar se në opinionin këshillëdhënës mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi se "autorët e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës të 17 shkurtit 2008 nuk kanë vepruar në emër të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë që funksionojnë në kuadër të Kornizës Kushtetuese, por vendimin e ka sjellë si përfaqësues të zgjedhur të popullit të Kosovës, të cilët bashkërisht kanë vepruar jashtë kornizës së administratës së përkohshme".<sup>24</sup> Në këtë mënyrë, ligjërish transformimi i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë të formuara në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KSKB-ve, rregulloret e UNMIK-ut dhe Kornizën Kushtetuese të Kosovës në institucione të Republikës së pavarur të Kosovës të formuara në bazë të Deklaratës së Pavarësisë dhe Kushtetutës së Kosovës është i diskutueshëm.<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Opinioni këshillëdhënës mbi Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, f. 48-49, gjendet në <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>

<sup>25</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës është nënshkruar më



Bazuar në Kushtetutën e Kosovës u krijua një kornizë e re juridiko-institucionale që në masë të madhe bazohej në rregulloret ligjore të UNMIK-ut dhe në Kornizën Kushtetuese të vitit 2001. Në këtë drejtim, në bazë të Ligjit nr. 04/L-034 dhe Ligjit nr. 05/L-080, u themelua Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) është themeluar si organ i pavarur publik që vazhdon t'i kryejë detyra që ishin nën autoritetin e AKM-së, të gjitha në përputhje me Ligjin nr. 04/L-115, i cili i referohet përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

7 prill 2008, është ratifikuar më 9 prill 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Teksti i Kushtetutës gjendet në [http://zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/USTAV\\_REPUB-LIKE\\_KOSOVO.pdf](http://zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/USTAV_REPUB-LIKE_KOSOVO.pdf)

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, u miratua Kushtetuta e re e Kosovës, që në nenin 159 merret me pronën dhe ndërmarrjet shoqërore dhe ku theksohet se prona shoqërore do të privatizohet pa asnjë vonesë, si dhe se e gjithë prona shoqërore në Kosovë është pronë e Republikës së Kosovës (neni 159 paragrafi 2). Neni 160 më tej specifikon se të gjitha ndërmarrjet shoqërore në Kosovë janë pronë e Republikës së Kosovës dhe se obligimet lidhur me të drejtat pronësore janë obligime të Republikës së Kosovës. Më tej, në këtë nen thuhet se me ligj Qeverinë e Kosovës mund të autorizohet që të privatizojë, jep me qira ose të jep me koncesion të gjitha ndërmarrjet në pronësi shoqërore, siç përcaktohet me ligj.

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës u krijua një kornizë e re juridiko-institucionale që në masë të madhe bazohej në rregulloret ligjore të UNMIK-ut dhe në Kornizën Kushtetuese të vitit 2001. Në këtë drejtim, në bazë të Ligjit nr. 04/L-034<sup>26</sup> dhe Ligjit nr. 05/L-080<sup>27</sup>, u themelua Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) është themeluar si organ i pavarur publik që vazhdon t'i kryejë detyra që ishin nën autoritetin e AKM-së, të gjitha në përputhje me Ligjin nr. 04/L-115, i cili i referohet përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.<sup>28</sup>

AKP ka vazhduar me privatizimin e ndërmarrjeve, veçanërisht të kompanive të mëdha shtetërore si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila i është shitur konsorciumit turk Limak & Çalık në vitin 2012 për 26.3 milionë euro.<sup>29</sup> Privatizimi i Postës dhe Telekomit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PTK) filloi në vitin 2013 dhe u zgjodh ofertuesi më i favorshëm, kompania gjermane *Axos Capital*, e cila ofroi 277 milionë euro për 75% të aksioneve të PTK-së, por shitja u bllokua nga Kuvendi, ku nuk kërkohej shumica e nevojshme për ta kryer këtë transaksion.<sup>30</sup>

<sup>26</sup> Ligji nr. 04/L-034 gjendet në <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20Privatization%20Agency%20of%20Kosovo.pdf>

<sup>27</sup> Ligji nr. 05/L-080 gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/Act-DocumentDetail.aspx?ActID=11296>

<sup>28</sup> Ligji nr. 04/L-115 gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2840&langid=2>

<sup>29</sup> Radio Evropa e Lirë "Nënshkruhet Marrëveshja e Privatizimit të KEK-ut, Protesta e Vetëvendosjes", gjendet në <https://www.slobodnaevropa.org/a/24742657.html>

<sup>30</sup> Artikulli B92 "Odložena privatizacija PT Kosova" od 25. shtator 2013.g., gjendet në <https://www.b92.net/biz/vesti/srbija/odložena-privatizacija-pt-kosova-757864?version=amp>

## 4. Privatizimi në mjediset serbe në Kosovë

Për dallim nga AKM-ja, AKP-ja filloi menjëherë privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe të tokës shtetërore në mjediset serbe.<sup>31</sup> Privatizimi kryesisht përfshinte shitjen e tokës shtetërore, të ndërmarrjeve shoqërore ose të pjesëve të ndërmarrjeve shoqërore, kryesisht të pa-tundshmërive në formë të ndërtesave, dyqaneve dhe objekteve të tjera afariste. Është e dukshme se komuniteti serb ishte informuar dobët për këto procese dhe shembujt e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve lokale nga komuniteti serb në proceset e privatizimit janë të rralla. Problemi qëndron edhe në mjetet tradicionalisht të dobëta të komunikimit të institucioneve të Kosovës me komunitetin serb, mediat e ndara sipas gjuhës dhe përkatësisë etnike, por edhe në përdorimin e gjuhës serbe në komunikimin zyrtar. Ka edhe probleme të tjera sistematike, si potenciali i dobët investues në mesin e biznesmenëve të komunitetit serb, por edhe biznesi i tyre në sistemin e dyfishtë (serb dhe kosovar). Përveç gjithë kësaj, ekziston një kundërshtim i qartë politik i komunitetit serb ndaj synimit të AKP-së për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe shtetërore në mjediset ku ata jetojnë.

Rezistenca ndaj privatizimit është sidomos e theksuar në rastin e privatizimit të ndërmarrjeve

<sup>31</sup> Artikulli i „KOSMET: Na prodaju preduzeća u srpskim sredinama”, gjendet në <https://www.vesti.rs/Kosovo/Kosmet-Na-prodaju-preduzeća-u-srpskim-sredinama-3.html>

të mëdha, siç janë Kombinati Xehetaro-Metalurgjik Trepça dhe Qendra e Skijimit në Brezovicë. Më 14 gusht 2000, UNMIK-u me ndihmën e KFOR-it mori përsipër menaxhimin e Trepçës me pretekstin e shqetësimeve mjedisore për shkak të funksionimit të shkrites. Më vonë, AKM-ja e kishte marrë përsipër menaxhimin e Trepçës, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, menaxhimi i këtij kompleksi është në duart e AKP-së. Në realitet, Trepça operon si dy ndërmarrje të veçanta, njëra prej të cilave menaxhon objektet në mjediset me shumicë shqiptare të Kosovës qendrore (përfshirë minierën e Stan Tërgut)<sup>32</sup> ndërsa tjetra në mjediset serbe në veri të Kosovës (p.sh. miniera e Belo Bërdo).<sup>33</sup>

Privatizimi i Qendrës së Skijimit në Brezovicë tregon edhe ngecjen e këtij procesi në komunitetet serbe. Në vitin 2009, AKP filloi privatizimin e disa pjesëve të Qendrës së Skijimit në Brezovicë me metodën e *spin-off-it* të rregullt. Në këtë mënyrë u privatizuan “Restoran brvnara Brezovica”, ndërmarrja “Mala brvnara” dhe ndërmarrja “Kafana Štrpce”. Mirëpo, privatizimi i pjesëve të tjera

<sup>32</sup> Më shumë për problemet e funksionimit të Trepçës në jug në artikullin e Radios Evropa e Lirë “Ugroženo funkcionisanje rudnika Trepča” dostupan na <https://www.slobodnaevropa.org/a/ugrozeno-funkcionisanje-rudnika-trepca/3327>.

<sup>33</sup> Më shumë për funksionimin e Trepçës në veri të Kosovës në artikullin e Insajderit. „Dimičić: Nećemo prepustiti upravljanje našim delom Trepče” <https://insajder.net/arhiva/vesti/dimic-ic-necemo-prepustiti-upravljanje-nasimce-akiliud-srpskog-dela-Trepče-zavisi-isključivo-od-Prishtine-gjendet-në-https://www.danas.rs/vesti/ekonomija/sudbina-srpskog-dela-trepce-zavisi-isključivo-od-pristine/>.



të Qendrës së Skijimit Brezovica te konsorciumi Francez-i Andorrës "DP Consulting - Compagnie des Alpes" për 400 milionë euro dështoi sepse komuniteti lokal dhe Qeveria e Republikës së Serbisë e kundërshtuan këtë procedurë. Në fund, privatizimi u ndal me veton e kryetarit të komunës së Shtërpçës.<sup>34</sup>

Gjithë këto vite pas vitit 1999, Qendra e Skijimit Brezovica ka punuar si pjesë e JP Ski Resorts të Serbisë. Mirëpo, Qeveria e Kosovës me masat e "fiskalizimit"<sup>35</sup> e pamundësoi funksionimin e kësaj ndërmarrje brenda sistemit të Serbisë dhe imponoi pranimin e menaxhimit të qendrës së skijimit nga Bordi i ri Drejtues i ndërmarrjes "N SH INEX SHARR PLANINA BREZOVICË SH.P.K" e themeluar nga AKP më 5 maj 2021 me pronësi 100%. Ky transformim u pasua me një sërë arrestimesh të zyrtarëve lokalë të komunës së Shtërpçës, përfshirë edhe ish-kryetarin e komunës, të gjitha me akuzën e dhënies së lejeve të kundërligjshme për ndërtim në Parkun Kombëtar.<sup>36</sup> Arrestimet shkaktuan protesta të komunitetit lokal,<sup>37</sup> por kjo nuk ndikoi në vendimin e Qeverisë së Kosovës për të marrë përsipër funksionimin e Qendrës së Skijimit në Brezovicë.

Ekzistojnë shumë ndërmarrje shoqërore në komunat e veriut të Kosovës që nuk janë marrë zyrtarisht nga AKP-ja dhe të cilat (ende) funksionojnë në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Serbisë. Në shumë prej tyre, prodhimi ka filluar me ndihmën e fondeve të Qeverisë së Republikës së Serbisë, kryesisht përmes subvencioneve të dhëna përmes Zyrës për Kosovë dhe Metohi. Ndonëse ka sfida të shumta në funksionimin e këtyre ndërmarrjeve, para së gjithash për shkak të dualitetit të sistemit

ligjor dhe problemeve në furnizimin me lëndë të parë, shumë prej tyre operojnë me një numër të konsiderueshëm punonjësish. Ndër shembujt e suksesshëm janë fabrika "Simpo"<sup>38</sup> dhe "Javor Neë"<sup>39</sup> nga Zubin Potoku.

Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS vitin e kaluar ka mbështetur anketën gjithëpërfshirëse të qëndrimeve dhe tendende në mjediset serbe në Kosovë, ku është shfrytëzuar mundësia për të pyetur qytetarët për nivelin e njohurive dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e privatizimit në Kosovë. Nga gjithsej 500 të anketuar, 21.2% e tyre (106 të anketuar) u përgjigjen se para luftës, ata ose dikush nga familja e tyre ka punuar në ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Ndër ta, shumica prej tyre kanë punuar nga 16 deri në 30 vjet (44.3%), nga 6 deri në 15 vjet (28.3%) dhe mbi 30 vjet (18.9%). Në pyetjen se cili është statusi i ndërmarrjes shoqërore për momentin, shumica prej tyre u përgjigjen se është në falimentim (40.6%), pastaj se është në proces privatizimi (28.3%) apo se funksionon si para luftës (11.3%). Marrë parasysh se procesi i menaxhimit të pronës shoqërore në Kosovë nuk e njej instrumentin e "falimentimit", kjo informatë flet shumë për nivelin e informimit të popullatës serbe për statusin e ndërmarrjes në të cilën ata kanë punuar. Mes të anketuarve që thanë se ndërmarrja ende ushtron veprimtari biznesi, gjysma sish pohojnë se ende punojnë për të, ndërsa gjysma tjetër se nuk janë më të lidhur me atë ndërmarrje, qoftë për shkak se vetë e kanë lënë punën ose janë pensionuar, por edhe sepse ata qenë shkarkuar pas luftës.

Gjithsej 8.5% u përgjigjen se privatizimi i ndërmarrjes në të cilën kanë punuar ka përfunduar dhe se pronari i ri ka mbajtur të njëjtën veprimtari, 1.9% kanë thënë se pas privatizimit, pronari i ri e ka ndërruar veprimtarinë e ndërmarrjes,

34 Kossev "Šta će biti sa Brezovicom", gjendet në <https://kossev.info/sta-ce-biti-sa-brezovica/>

35 RadiokIM "Normalizimi dhe fiskalizimi", gjendet në <https://www.radiokim.net/vesti/analiza/normalizacija-i-fiskalizacija.html>

36 Radio Evropa e Lirë "Na Kosovo nova hapšenja u okviru akcije Brezovica", gjendet në <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-akcija-brezovica-nova-hapšenja/31755975.html>

37 RTS "Protest u Štrpcu zbog nedavnih hapšenja", gjendet në <https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/125/drustvo/4744431/strpce-protest-hapšenja.html>

38 InfoVranjske "Simpo ponovo u akciji Zubin Potok", gjendet në <https://infovranjske.rs/simpo-ponovo-u-akciji-zubin-potok/>

39 RTS "Javor pokrenuo proizvodnju u Zubinom Potoku", gjendet në <https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/13/ekonomija/3802952/javor-pokrenuo-proizvodnju-u-zubinom-potoku.html>

ndërsa 9.4% nuk kanë ditur të përgjigjen se çfarë statusi ka ndërmarrja ku ata kishin punuar para luftës.

Të gjithë të anketuarit që kanë thënë se ndërmarrja ku kanë punuar aktualisht është në proces privatizimi, kanë deklaruar se ndërmarrja funksionon në sistemin serb, gjë që është disi e palogjikshme, sepse zyrtarisht privatizimi është bërë nga AKP-ja, që gjithashtu menaxhon me ndërmarrjen deri në shitje përfundimtare. Ky informacion tregon nivelin e informimit të qytetarëve për procesin e privatizimit në Kosovë. Ata po ashtu u përgjigjen se rrogën e marrin në dinarë, që është tregues se ata punojnë në ndërmarrje që funksionojnë në sistemin serb.

Në pyetjen e të anketuarve që kanë punuar në një ndërmarrje që është subjekt i privatizimit, nëse dikush i ka kontaktuar për marrjen e aksioneve në kompani, 96.7% u përgjigjen se nuk është kështu (vetëm një i anketuar është përgjigjur se është kontaktuar për këtë çështje).

Janë marrë gjithsej 11 përgjigje në temën e ndërmarrjeve tashmë të privatizuara, ku tre të anketuar u përgjigjen se kanë marrë para si kompensim financiar nga privatizimi, ndërsa tetë të anketuarit e tjerë janë përgjigjur negativisht në këtë pyetje. Të tre të anketuarit që kanë marrë para janë shprehur të pakënaqur me shumën e kompensimit. Të anketuarit që nuk janë kompensuar financiarisht nga privatizimi, nuk e dinë arsyen pse ka ndodhur kjo.

Është e nevojshme të ceket problemi i mungesës së të dhënave me rëndësi publike në fushën e privatizimit. Prandaj, nuk është e mundur të vërtetohet nëse ndonjë nga pronarët apo kreditorët nga komuniteti serb është kompensuar pas shitjes së ndërmarrjes shoqërore në Kosovë. Gjithashtu, nuk është e mundur të vërtetohet se sa pjesëtarë të komunitetit serb kanë marrë kompensim nga mjetet e fituara në procedurën e privatizimit në bazë të vjetërsisë së tyre në ndërmarrjen shoqërore që është subjekt i privatizimit.

# 8.5%

**u përgjigjen se privatizimi i ndërmarrjes në të cilën kanë punuar ka përfunduar dhe se pronari i ri ka mbajtur të njëjtën veprimtari,**

# 1.9%

**kanë thënë se pas privatizimit, pronari i ri e ka ndërruar veprimtarinë e ndërmarrjes, ndërsa**

# 9.4%

**nuk kanë ditur të përgjigjen se çfarë statusi ka ndërmarrja ku ata kishin punuar para luftës.**

## 5. Republika e Serbisë dhe privatizimi në Kosovë

Qeveria e Republikës së Serbisë e kundërshton fuqishëm privatizimin në Kosovë, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës, e cila u krijua në bazë të shpalljes së njëanshme të pavarësisë, nuk ka bazë ligjore për të disponuar me pronat e Republikës së Serbisë dhe të Republikës Federale të Jugosllavisë në territorin e Kosovës. Në këtë kuptim, Qeveria e Serbisë i referohet Rezolutës 1244/1999 të KSKB-ve dhe thekson se UNMIK-u ka të drejtë të menaxhojë pronën, por nuk ka të drejtë ta ndërrojë marrëdhënien e pronësisë ndaj pronës publike, shtetërore dhe shoqërore në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Serbisë ka reaguar shumë herë ndaj privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore në Kosovë, por rezultatet e atyre reagimeve janë gjysmake. Kështu, për shembull, Qeveria e Serbisë pranë Kombeve të Bashkuara arriti të ndalojë valën e parë të privatizimit në vitet 2003 dhe 2004. Megjithatë, kjo ishte jetëshkurtër sepse Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian ia transferuan përgjegjësinë AKP-së nga vetja dhe u krijua një model i ri privatizimi në atë mënyrë që pretendimet dhe marrëdhëniet e pronësisë të zgjidhen në një procedurë (të paqartë) pas privatizimit.

Zyra për Kosovë dhe Metohi nuk ka informata të plota për pronën që e pretendon në Kosovë. Sipas të dhënave jo të plota, ndërmarrjet nga Serbia kanë rreth 1400 objekte në Kosovë, prej të cilave PTT Serbia ka 130 objekte, Kompania e Transportit Hekurudhor ka 55 objekte, EPS ka 19, "Srbijašume" ka 45 objekte. Ndër të tjera, "Lola korporacija" ka

fabrika në Zubin Potok, Leshko, Shtërpce dhe Viti. "Termovent" nga Temeri ka fabrika në Rahovec dhe Lipjan, "Zelengora" në Suharekë, "Minel" në Prishtinë, Mitrovicë e Klinë, "Coca Cola" në Lipjan, "Goša" nga Smedereva në Gjilan, etj. Krahas gjithë këtyre, Qeveria e Serbisë thekson se zhvillimi i Kosovës është financuar nga Fondi Federal për Zhvillimin e Zonave të Pazhvilluara, por edhe nga Fondi Krahinor i Zhvillimit, ndërsa pasardhësi juridik është Fondi për Zhvillim i Republikës së Serbisë i atyre fondeve. Nga viti 1992, ekonominë në Kosovë e kishte kredituar Fondi për Zhvillim i Republikës së Serbisë, deri më 1997, kur këtë funksion e mori Drejtoria për Zhvillimin e Kosovës dhe Metohisë, me seli në Prishtinë. Përveç kësaj, Fondi ka edhe aksione si aksione të përhershme në 163 ndërmarrje të atjeshme, në shumicën e rasteve më shumë se 51 për qind të aksioneve, për të cilat është informuar edhe AKP-ja.<sup>40</sup>

Në këtë proces është përfshirë edhe Oda Ekonomike e Serbisë (OES), e cila disa herë ka kërkuar nga Asociacioni Botëror i Odave Ekonomike që të ndihmojë në rishikimin dhe ndalimin e privatizimit të ndërmarrjeve në Kosovë, pasi që është kryer pa vërtetim të detajuar të pronësisë. Sipas OES-it, ndërmarrjet në Kosovë janë privatizuar në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, në kundërshtim me Rezolutën 1244/1999 të KSKB-ve dhe në dëm të pronarëve të ndërmarrjeve.

40 Gulan Branislav „Privatizacija na Kosovu i Metohiji“, Ekonomski anali, 4. shtator 2020, dostupno na <https://www.makroekonomija.org/kosovo/privatizacija-na-kosovu-i-metohiji/>

## 6. Përfundim

Që nga fillimi, privatizimi në Kosovë është përcjellë me polemika nëse UNMIK-u ka autoritet vetëm për të menaxhuar pronën publike, shtetërore dhe shoqërore, apo nëse ka të drejtë ta transformojë pronësinë mbi pronën që i është dhënë për menaxhim. Pas njëfarë pavendosmërie, UNMIK-u e zgjidhi këtë dyshim duke themeluar AKP-në, së cilës ia barti përgjegjësitë për menaxhimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore, por edhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje me rëndësi për funksionimin e AKP-së, e cila i krijoi kushtet e nevojshme për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore në Kosovë, si dhe të pronës publike (tokës). U krijua një model privatizimi me *spin-off* që nuk merre në konsideratë çështjen e pronësisë (ose kreditorëve) të pronës që është subjekt i transformimit të pronësisë, d.m.th. nuk u krijuan mekanizma të qartë për të përcaktuar pronarët apo kreditorët e vërtetë dhe as instrumentet për kompensimin e tyre. Ky model është mjaft i diskutueshëm, si nga ana juridike, ashtu edhe nga ana e paqimit ndërmjet bashkësive etnike në Kosovë. Fokusi kryesor i modelit të privatizimit ishte shitja e ndërmarrjes, ose të paktën e pjesës së aseteve të ndërmarrjes që kishte vlerë tregu, ndërsa të gjitha çështjet e tjera u lanë për t'u zgjidhur në një procedurë të mëvonshme, gjë që nuk ndodhi kurrë. Në këtë mënyrë u krijuan kushte për diskriminim në baza etnike, sepse pjesëtarët e komunitetit serb (dhe grupeve të tjera etnike) nuk ishin mjaftueshëm të kënaqur në këtë proces, nëse kishin bazë për kompensim financiar në bazë të pronësisë, pretendimeve

të bazuara për borxh ose bazuar në të drejtat për aksione në bazë të angazhimit në punë në ndërmarrjet shoqërore. Diskriminimi ka të bëjë edhe me pronarët dhe kreditorët nga Serbia të cilët gjithashtu nuk kompensohen në kuadër të zbatimit të këtij modeli të privatizimit.

Në kuptimin juridik, situatën e komplikon edhe më shumë shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës dhe shndërrimi i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në institucione të Republikës së Kosovës. Në rrethana juridikisht të paqarta, prona publike, shtetërore dhe shoqërore që i ishte dhënë në menaxhim UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244/1999 të KSKB-ve, u bë pjesë e pronës së Republikës së pavarur të Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe aktet përcjellëse ligjore krijuan instrumente të reja ligjore dhe institucionale për vazhdimin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore. Lidhur me këtë është formuar AKP-në me mandat për të përfunduar procesin e privatizimit në Kosovë. Sukseset e AKP-së janë të diskutueshme dhe shumë privatizime kanë dështuar ose janë bërë objekt i skandaleve korruptive. Ndër privatizimet e dështuara, veçohet blerja e pasuksesshme e PTK-së, e Qendrës së Skijimit Brezovica dhe shumë ndërmarrjeve të tjera.


Një nga polemikat me punën e kësaj agjencie lidhet edhe puna e AKP-së në mjediset serbe dhe komunikimi me komunitetin serb. Posaçërisht nuk dihet puna e AKP-së në komunitetet serbe në komunat në veri të Kosovës, gjë që u vërtetua, mes tjerash, edhe përmes anketës së

opinionit publik që pjesërisht e përcjelli përgatitjen e këtij dokumenti.

Edhe sjellja e Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe e autoriteteve të saj në çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve publike, shtetërore dhe shoqërore në Kosovë është e diskutueshme. Në fillim të privatizimit në Kosovë, Serbia pati njëfarë suksesi në ndalimin e këtij procesi, ndërsa në periudhën e mëvonshme ndikimi i Serbisë ishte marginal. Rezistenca e Qeverisë së Serbisë dhe e aktorëve të tjerë (p.sh. OES) është më simbolike, e paorganizuar dhe zbatohet në mënyrë jo sistematike. Prandaj, nuk është për t'u habitur që Qeveria e Serbisë nuk ka iniciuar ndonjë procedurë ligjore kundër Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian apo ndonjë subjekti tjetër juridik që ka marrë pjesë në privatizimin e pronave dhe ndërmarrjeve në Kosovë. Gjithashtu, publikisht nuk ka një listë të besueshme të pronave publike, shtetërore dhe shoqërore të pretenduara nga Serbia në Kosovë, që mund të jetë subjekti i pretendimeve gjatë negociatave për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Fokusi i Qeverisë së Serbisë është kryesisht në pronat apo bizneset në mjediset serbe në Kosovë, ku reagon në koordinim me zyrtarët lokalë. E drejta e pronësisë ndaj pronës në mjedise të tjera kryesisht nuk përmendet. Përrjashtim bën theksi mbi pronësinë ndaj pronës në fushën e energjisë, kryesisht impiantet energjetike dhe rrjetin e shpërndarjes. Privatizimi i Qendrës së Skijimit Brezovica shpjegon më së miri mënyrën se si Serbia ka vepruar në këtë proces. Megjithatë, edhe në rastet e privatizimit në mjediset serbe, Qeveria e Serbisë nuk ka ofruar asistencë adekuate juridike apo administrative në mbledhjen e të gjitha informatave dhe fakteve relevante që do t'i ndihmonin zyrtarët lokalë apo popullatën lokale që të arrijnë pozitën më të mirë të mundshme në procesin e privatizimit. Ashtu si në rastet e tjera të ndryshimeve transicionale në Kosovë, strategjia e Qeverisë së Serbisë është që të realizohet bojkoti ndaj institucioneve të Kosovës, por jo që nga procesi ekzistues të nxirret përfitimin maksimal për popullatën lokale serbe.

## Rekomandimet e mëposhtme dalin nga gjetjet dhe përfundimet e këtij dokumenti:

- Rritja e transparencës së punës së AKP-së dhe forcimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e komunave me shumicë serbe;
- T'i qasen mbledhjes sistematike të të gjithë informatave të nevojshme që vërtetojnë marrëdhëniet e pronësisë dhe të drejtat e punëtorëve në ndërmarrjet shtetërore dhe shoqërore në mjediset serbe;
- Të ofrohet ndihmë juridike dhe administrative për popullsinë vendase që është prekur në çfarëdo mënyre nga procedurat e privatizimit;
- Përfshirja e çështjes së pronësisë dhe e pretendimeve në procesin e negociatave për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.



Qeveria e Serbisë nuk ka ofruar asistencë adekuate juridike apo administrative në mbledhjen e të gjitha informatave dhe fakteve relevante që do t'i ndihmonin zyrtarët lokalë apo popullatën lokale që të arrijnë pozitën më të mirë të mundshme në procesin e privatizimit.



Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

